

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e Prokurimit KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT PRISHTINA SH.A.	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
	OE ankues SAMIRE OSMANI B.I.		
Prej:	Abetare Prebreza – Ekspert Profesional i Prokurimit		
Lënda:	Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me nr. 302/19 të parashtruar nga OE “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë		
Datë	17.06.2019		

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës 11.06.2019 me nr. 302/19 të parashtruar nga OE “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim ne Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A.” me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT PRISHTINA SH.A.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veproj sipas kërkesave të Nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT PRISHTINA SH.A.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – SAMIRE OSMANI B.I.


Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për “Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim ne Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A.” me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Prishtina Sh.A.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

	<b>13.06.2019</b>	<b>17.06.2019</b>
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>	<i>Data e autorizimit të ekspertit</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i>

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 11.06.2019 OE “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër Vendimit të AK për dhënie, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektim, Dezinsektim dhe Deratizim në Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A.” me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237 Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**Operatori Ekonomik ankues “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë**

**Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë**

AK gjat vlersimit të kësaj oferte Tenderuese ka bërë shkeljet e LPP-së: Neni 65 Paragrafi 2, Neni 66 Pika 2. Neni 68, 71 dhe Neni 72.

**Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet**

Kërkesa jone thirret në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Kërkesa jone nuk pajtohet në Vendimin e datës: 05.06.2019 të AK - KRU PRISHTINA SH.A. ndaj kërkesës sonë për Rishqyrtimin e lëndës pasi që ne si OE kemi kërkuar në mënyrë të qartë gjatë prezantimit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit AK për disa nga Leshimet e tyre gjatë procesit të vlersimit të OE i shpallur fitues për këtë procedurë prokurimi nuk është i përgjegjshëm dhe ne e kundërshtojmë bindshëm këtë vendim me fakte për secilën pikë të cekur në këtë Vendim.

Gjithashtu ne thirrëmi duke u bazuar në nenin 72 të ligjit të prokurimit Nr. 04/L-042.

Sa i përket Pikes 1 në Vendimin e datës: 05.06.2019, është e vërtetë që OE ka paraqitur vetëm një letër (1 faqe) ku OE Autorizohet nga antari Konzerciumit mirpo nuk ceket asnjë marrvëshje se si do të përfundojnë punimet dhe nuk posedojnë Deklaratë për secilin nga antarët e Konzerciumit.

Deklarata nën Betim e prezantuar është Obligative për secilin OE sipas FTD Aneksi 1, mirpo nuk mund merret



edhe si plotsuese e Deklarates e cila duhet te ipet me antaret e Konzerciumit, ju lutem deklaratat e grupit te konzerciumit te shqyrtohen me detajet siq kerkohen nga LPP e jo te jene vetem formale dhe ne kete aspekt pretendimi yne ka qen qe te reagojrn dhe ases te beje leshime AK.

Deshmia 1: Deklarata te Prezantuar nga AK (Te marra me daten 30.05.2019 gjate Procedures per Qasje në Dokumentacion)

Tek Pika 2 në Vendimin e AK te prezantuar me: 05.06.2019 ku ankesa Jon ceket ne detaje qe OE i cili eshte shpallur fitues nuk Posedon Licenc per Importimin e produkteve Biocide dhe kemi japur sqarim qe OE ka prezantuar nje Flet Aplikacioni ku tregon qe ska Licenc por vetem ka apliku ne MMPH per tu paisur, Ne si pale e demtuar jemi injoruar me kete pike duke marr si ankes te pabazuar nga AK. Aty OE shpallur fitues pos Flete aplikacionit ka Prezantuar nje Vendim i cili eshte i leshuar me: 09.09.2014 dhe eshte Valid vetem per 1 vit qartazi shkruan ne faqen 2 te ketij Vendimi, Ju Lutem OE pasi vetem ka apliku per tu paisur me Leje nuk mund te plotsoj Kerkesen sipas FTD te Prezantuar nga AK ku kerkohe qe OE duhet te posedoj Leje per importim te produkteve Biocide te leshuar nga MMPH-ja. ose Licenc per qarkullim me shumice te produkteve medicinal/Veterinare. sepse nuk e Posedon Vendimin i cili merret pas disa kohe pas aplikimit, andaj lusin, ekspertet qe te informohem ne detaje rreth pasisje me Licencen e till dhe ti Rekomandojn AK qe nuk mundet te konsiderohet dokument Ekuivalent flet aplikacioni apo nje Vendim i vitit 20 ku ajo Licenc ka pasur afat kohor 1 vit dhe tani jemi ne Qershor 2019, Ju lutem sqarimin nmerreni te bazuar sepse nje OE duhet te kaloj neper disa etapa nga koha e aplikimit e derisa ajo Licencohet per Importin e produkteve Biocide sepse data e aplikimit le OE dhe ne fund data e marrjes se Licencen te kerkuar nga AK kerkon kohe ateher eshte absurde të merret parasysh nje aplikacion sepse ne fund AK duhet ti interesoj Data e Licences apo Vendimit, a mund te leshohet Licenca para dates se hapjes se tenderit do te ishte diqka jonormale te japim pergjigje pozitive. Ju lutem vtern ne kete aspekt shqyrtone dhe do te bindeni qe OE nuk eshte i pergjegjshem. Ne si moster i kemi propozuar AK qe te analizon Licencen e till te prezantuar nga OE "SAMIRE OSMANI" BI. Poashtu vlen te ceket se tek pas kerkeses per Rishqyrtim pra pas Vendimit per Refuzim nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontrakities ia ka derguar nje Licenc te OE fitues te dates 19.04.2019 e ku dihet qe data e ofertimit ka qene data 17.04.2019. Poashtu vlen te ceket edhe komunikimi me AK i dates 05.06.2019 siq vijon:

OE ne momentin e aplikimit nuk ka pasur licenc dhe ka prezentuar vetem nje kerkese dhe data e dorzimit te ofertave ka qene 17.04.2019 ora 14:00 dhe fakt i pa mohueshem eshte qe ky Operator Ekonomike licencen e ka marre me date 19.04.2019 me numer protokoli 2015-2/19 dhe sipas vendimit per Import te produkteve biocide te nostrifikuara, vendimi hyne ne fuqi dite e nenshkrimet.

Po e riperseis kerkesen sipas FTD

d.Operatori Ekonomik duhet te posedoje Leje per import të produkteve biocide të notifikuara leshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose te kete licence per qarkullim me shumice te produkteve medicinale dhe/apo veterinare; Dëshmia e kerkuar dokumentare: d. Kopjen e Licenses ose lejes;

Pra keni kerkuar leje me shumice per produktet te notifikuara ndersa Operatori Ekonomik fitues e ka vetem lejen per Import te dates 19.04.2019 per Deratizim - Rodeticide me permbajtja aktive Bromadiolone 0.05 %. Pra e ka vetem nje produkt e jo siq keni kerkuar ju si AK kete licence per qarkullim me shumice te produkteve medicinale dhe/apo veterinare dhe ku dihet qe ne institucionet tuaja kane mu kry sherbime Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim .Pra edhe nese e marrim per baze qe OE fitues gje që nuk duhet te ndodhe) posedon licenc per Importim te Produkteve Biocide atehere fakt i pamohueshem eshte qe ky OE nuk eshte i licencuar per importim te produkteve biocide me shumice por vetem per nje lloje produkti qe quhet Rodeticide me permbajtja aktive Bromadiolone 0.05% e jo siq keni kerkuar ju si AK qe te kete licence per qarkullim me shumice te produkteve medicinnle dhe/apo veterinare.

Deshmia 2: Aplikacioni dhe Vendimi i 2014 (Te marra me datën 30.05.2019 gjatë Procedures - Qasje në Dokumentacion) si dhe vendimi i dates 19.04.2019 nga MMPH-ja per import te vetem e produkti. Shkeljet nga AK per Refuzim te Ankeses sone dhe Vazhdimin e procedures per shpalljen Fitues te OE i cili nuk posedon kerkesen 7.1 sipas FTD-s.



OE SAMIRE OSMANI B.I gjate procesit te qasjes në dokumetacion konfirmojne se Pikat 2 e cekuara ne Vendimin per anulimin e Procesit te Rivlersimit ku sipas AK gjeet tona nuk jane te bazuara per Eliminim e OE shihet qart se si AK ka here shkelje te LPP-se Duke shpallur fitues nje OE i cili nuk posedon Licencen e kerkuar nga vet AK.

Tek pika e radhes ku sipas FTD kerkohen Kontrata dhe Referencat gjat tri viteve te fundit OE i shpallur fitues ka prezantuar vetem 1 Kontrat dhe Referenc nga Komunna e Obiliqit e cila mund te merret valide sipas LPP sepse eshte nga nje institucon kredibil ndersa 2 kontratat tjera jan ndermjet OE privat andaj duhet deshmohen me dokumente apo deshmi bindse siq jan konfirmimet bankare apo faturat tatimore sepse nuk jane institucione Kredibile per tu marr kontratat dhe Referencat e tyre Dokumente valide.

- Operatori Ekonomike fitues nuk ka referenca te mjaftueshme pasi qe njera eshte e dates 01.03.2016 qe nuk eshte ne perputhje sipas kerkesa te njoftimit per kontrate ku kerkohet qe nga data e publikimit operatori ekonomike te ofroje kontrata, referenca. Poashtu antari i Konserciumit ka derguar disa Referenca ne gjuhen Serbe permes fotove ku keto Referenca kane nderhyrje ne to permes laps kimikut dhe qe se tregojne aspak seriozitetin e nje dokumenti zyrtar dhe valid

Deshmia 3: Kontratat dhe Referencat (te marra me daten 30.05.2019) gjatë Procedures - Qasje në Dokumentacion)

Sa i perket shkeljeve Ligjore jan te shumta mirpo ne si OE të cilet jemi të habitur deshirojmë te cekim një detal që si OE jemi plotsisht të zhgenjyer gjat procedures per qasje në dokumetacion ku shihet qan qe OE nuk eshte i pergjeshem Administrativisht mirpo shperblimi me kontrate eshte prap i pa shmangshem.

Ndersa tek Kapaciteti Teknik OE lider nuk ka prezantuar asnje Paisje ateher sipas LPP antari i konzerciumit duhet te plotsoj mngasite e OE ne fjale, Antari i Konzerciumit ka prezantuar disa foto te Listes se Makineris dhe Fatura mbi disa nga paisjet te cilat i posedon mirpo ne ate Fatura apo deshmi mbi pajisje nuk posedojn pershkrimi siq kerkohet tie FTD andaj do te ishte absurd sikur ne ti marrim si kriter te plotsuar nga antari i Konzerciumit te OE i cili eshte Lider dhe njekohsisht Fitues i tenderit.

Tek Kapaciteti Teknik OE nuk ka prezantuar asnje paisje ndersa fotografit e prezantura nga antari i konzerciumit nuk perkojn me kerkesat ne FTD nga AK siq kerkohen deshmit perciellse per paisjet: kontrata e blerjes, fatura kopje ape dokumentet e zhdoganimit (DUD-i) Antari Konzerciumit ka paraqitur disa fotografi ku nuk vrehet asnje pershkrim i paisjeve qartazi dhe secili dokument ka ngjyren e stilolapsit qka korrespondon me dokumentacion zynar. Ne asnje aspekt keto dokumente nuk mund te mirren si dokumente zyrtare valide. pasi qe nuk kane tipare te karakterit e te seriozitetit

Deshmia 4 Paisjet e prezantuara nga antari i konzerciumit (Te marra me datën 30.05.2019 atë Procedures - Qasje në Dokumentacion)

Kerkojm nga OSHP qe kërkesa të aprovohet pasi qe pikat per të kemi dhe ne besoj informacionin e duhur, jane të bazuara në fakte si OE shpresojme fuqishem ne vendimin per shpalljen fitues, ne Zotohemi per plotsimin e te gjitha pozicioneve siq jan paraparë në paramas te ofruar nga ne si OE.

#### Dëmet materiale

AK na ka shkaktuar Deme Materiale per arsye jo transparente ne lidhje me Vendimin e shpallur per fitues, kjo periudhë permblet dhe kostot e pritjes per fillimin e punimeve te parapara ne Planin Ditarik te Punimeve, Shpenzimet per pergaditjen e ofertes teknike, shpenzimet e sigurimit te tenderit, shpenzimet e angazhimit te ekspertave per pergaditje te kerkeses per Rishqyrtim, shpenzimet e angazhimit te avokatit per kete aktivitet te

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për "Dezinfektim, Dezinsktim dhe Deratizim ne Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A." me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina Sh.A.



eliminimit dhe ne aspektin kohore dhe demtime ne vleren e kontrates prej 11,328.00 Euro qe besojme fuqishem se jemi te kompletuar me dokumentacionin e kerkuar sipas dosjes se tenderit nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimet ankimore janë të njëjta si në Kërkesën për rishqyrtim.

### Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë .....	25.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar .....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar .....	Shërbim, vlerë e mesme
Vlera e parashikuar e kontratës .....	20,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52) .....	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave .....	17.04.2018
Data e hapjes së ofertave .....	17.04.2018
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave .....	27.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm .....	29.05.2019
Data e Vendimit së AK për dhënie të kontratës .....	29.05.2019
Data e Kërkesës për rishqyrtim .....	03.06.2019
Data e Vendimit të AK-së lidhur me Kërkesën për rishqyrtim .....	05.06.2019

### Kriteret për vlerësim

#### *Kërkesat e përshtatshmërisë*

Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesën mbi përshtatshmërinë të ligjit të prokurimit, Ligji Nr.04/ L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit-aneks 2

Përveç deklaratës së shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon:

a.Për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetimi i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

b.Për situatën referuar nenit 65, paragrafit 4, nen-paragrafit 4.8 (kontributi i sigurimit social), 4.9 dhe 4.11

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për "Dezinfektim, Dezinfektim dhe Deratizim në Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A." me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina Sh.A.



certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë tilla nuk ekziston.

c. Për situatën referuar nenit 65, paragrafit 4, nen-paragrafit 4.8 (tatimit), Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

d. Për situatën referuar nenit 65, paragrafit 4, nen-paragrafit 4.9 (pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike) certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik (KUR Prishtina sh.a) që një situatë tilla nuk ekziston;

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

#### *Përshtatshmëria profesionale*

a. Operatori Ekonomik tenderuesi duhet të jetë i regjistruar si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e themelimit të operatorit ekonomik

b. Operatori Ekonomik tenderuesi duhet të jetë i regjistruar si parapagues për TVSH

c. OE- Tenderuesi duhet të jetë i licencuar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për kryerjen e shërbimeve të ngjashme (Dezinsektim, Dezinfektim dhe Deratizim)

d. Operatori Ekonomik duhet të posedojë Leje për import të produkteve biocide të notifikuara lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose të kete licence për qarkullim me shumicë të produkteve medicinale dhe/apo veterinarë

e. Operatori Ekonomik duhet të posedojë Certifikatat e analizës së dezinfektuesve, dezinfektuesve dhe deratizuesve ose ndonjë certifikatë tjetër ekuivalente që lejon përdorimin e dezinfektuesve, dezinfektuesve dhe deratizuesve

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

a. Kopje e certifikatës për regjistrim të biznesit

b. Kopja e certifikatës për TVSH;

c. Kopja e Licenses ose lejes;

d. Kopjen e Licenses ose lejes;

e. Kopjen e Certifikatës së analizave ose ekuivalente

#### *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*

Operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit, numerimi retroaktiv nga data e njoftimit për kontratë, veçmas ose të llogaritura së bashku, duhet të ketë pasur qarkullim financiar së paku në vlerë prej 30,000.00 euro

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

Operatori ekonomik si dëshmi duhet të dorëzojë vërtetimet nga administrata tatimore në vendin e themelimit ose pasqyrat financiare të audituara nga ndonjë auditor kompani e licencuar e auditimit

#### *Kapaciteti teknik dhe profesional*

a. Operatori Ekonomik Tenderuesi me rastin e dorëzimit të tenderit duhet të dëshmojë se ka kryer së paku dy shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit, duke filluar numerimi prapa nga data e njoftimit për kontratë.

b. Operatori Ekonomik Tenderuesi duhet të dëshmojë se, në kuadër të stafit të vet, OSE në rast të tenderimit në grup në kuadër të stafit nga anetari tjetër i grupit, së paku një 1 mjek veterinar dhe një 1 teknik veterinar, të dy të certifikuar për kryerjen e shërbimeve të kërkuara për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim (DDD)

c. Operatori Ekonomik Tenderuesi duhet të dëshmojë se ka në pronësi të vet OSE të marra me qira pajisjet për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim (DDD), siç janë cekur në listen e dhënë në Aneksin 7, e që janë:

-Dezinfektim

1) Pompë Motorike ULV;



2)Nje Paisje elektrike per mjegullim te ftofte dhe me permbajtje aktive te dezinfektuesve si Dimetildioktil ammonium chloride,Benzalkoniumklorid;

-Dezinsektimi

3)Pompë Motorike ULV;

4) aparatura te cilat krijojne tym (foger);

5) atomizer qe perdoret per dezinfektim hapsinor

*Dëshmia e kërkuar dokumentare*

a.(i) nese sherbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben nje Letër Reference te leshuar nga ana e AK OSE fletdergese fletpranim ose dokumentit per pranim teknik te pajisieve, e cila duhet te jete e nenshkruar nga ana e AK. a.(ii) nese sherbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij ivrimi ekzekutimi shërben kopje e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti qe evidenton nje ekzekutim të tillë.

b. Kopjet e kontratave valide te punes dhe certifikatave qe deshmojne se jane te diplomuar, licencuar dhe apo certifikuar per sherbimet te Dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim (DDD);

c. Liste te pajisjeve, sipas aneksit 7 te dokumentit te tenderit, me dëshmi përcjellese te posedimit te tyre siç janë kontratat e blerjes, kopjet e faturave te paguara per to, dokumentet e zhdoganimit te tyre apo kopje te kontrates per marrjen me qira te tyre.

#### Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi (€)	Vërejtje
1	SAMIRE OSMANI B.I.	Leshanë	11,328.00	Jo
2	Grup i OE VLERA SHPK; EKO DEZ DOO BEOGRAD	Shtime	9,817.60	Jo
3	MALË MALA B.I.	Viti	19,635.20	Jo

#### Komisioni vlerësues pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

1. Nazmi Gashi
2. Nazmi Visoka
3. Armend Maka
4. Qendrim Ahmeti

#### Raporti i komisionit vlerësues

*(Shënim i Ekspertit: më poshtë është shkruar teksti sipas anëtarëve të komisionit të vlerësimit)*

1. Nazmi Gashi - Nuk ka shkruar asgjë.

2. Nazmi Visoka - Ofertuesi 1. Samire Elshani – Leshan dhe ofertuesi 2. Vlora – Shtime kanë konkuruar për tenderin e D.D.D. prandaj unë dyshoj në cilësinë e kualitetit të punës së tyre prandaj unë i shoh si ofertues të papërgjegjshëm. Unë si antar i komisionit për vlerësim propozoi që tenderti të përsëritet.

Shkrimi për anëtarin e dytë të komisionit të vlerësimit dhënë nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit tek Raporti i vlerësimit: “Komente nga zyrtari i prokurimit: Deklarata e anëtarit të komis. vlerësues z. N. Visoka konsiderohet e pabazuar sepse: Çështja e parë – Çmimet shumë të ulëta! Dep. Prokurimit ka verifikuar çmimet për tend. Jo-normalisht të uëlt sipas rregullave në fuqi dhe me këtë rast OE VLERA SHPK me dëshmi dhe

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për “Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim në Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A.” me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina Sh.A.

*Qm*



shkrim ka konfirmuar “qëndrueshmërinë” e çmimeve të ofruara; Çështja e dytë: propozimi për anulim! Ky propozim nuk qëndron sepse të tre OE janë të përgjegjshëm.”

3. Armend Maka - Propozoj që me kontratë të shpërblehet OE VLERA SHPK; EKO DEZ DOO për arsye se e plotëson kriterin tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët.

4. Qendrim Ahmeti - Propozoj që me kontratë të shpërblehet grupi OE VLERA SHPK; EKO DEZ DOO BEOGRAD.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues.

Emri i OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi (€)
Grup i OE VLERA SHPK; EKO DEZ DOO BEOGRAD	Shtime	9,817.60
SAMIRE OSMANI B.I.	Leshanë	11,328.00
MALË MALA B.I.	Viti	19,635.20

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave rekomandon për fitues OE Grup i OE VLERA SHPK; EKO DEZ DOO BEOGRAD me çmim prej 9,817.60 €.

Raporti i vlerësimit është i nënshkruar nga tre nga katër anëtarët e komisionit për vlerësim dhe nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “SAMIRE OSMANI B.I.” Suharekë**

##### **Përgjigje në Pretendimin nr. 1**

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 65 dhe 71 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur “vetem nje leter (1 faqe) ku OE Autorizohet nga antari Konzerciumit mirpo nuk ceket asnje marrëveshje se si do ti perfundojnë punimet dhe nuk posedojnë Deklarat per secilin nga anëtarët e Konzerciumit”, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Deklaratat nën betim për të dy anëtarët e grupit dhe ka ofruar Deklaratën mbi themelim të grupit të nënshkruar de vulosur nga të dy anëtarët e grupit me të gjitha të dhënat e kërkuara dhe sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar marrëveshje shtesë për kryerje të punimeve.

##### **Përgjigje në Pretendimin nr. 2**

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 66 dhe 72 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk posedon licencë për importim të produkteve biocide dhe se nuk e ka licencën për qarkullim me shumicë të produkteve medicinale dhe / apo veterinare, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme dosje të tenderit është kërkuar që “Operatori Ekonomik duhet të posedojë Leje për import të produkteve biocide të notifikuara lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose të kete licence per qarkullim me shumice te produkteve medicinale dhe/apo veterinare”, pra është kërkuar që OE të kenë vetëm njërin nga këto dy dokumente.

- Eksperti sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontrates në ofertë ka ofruar “Aplikacionin për dhënien e produkteve biocide” të protokoluuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 10.04.2019 me Nr. Prot. “2015/19” dhe dokumentin prej tre faqesh të nënshkruar dhe vulosur me titull “Leje për import të produkteve biocide të notifikuara” të datës 09.09.2014 me numër të referencës “14/4193/1-340-DMMU” të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sqaron se ky dokument ka vulën e protokolit me datë 16.09.2014 me Nr. Prot. “4193-2/14”. Eksperti sqaron se në këtë

Raporti i Ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE për “Dezinfektim, Dezinsktim dhe Deratizim ne Objektet e KRU PRISHTINA Sh.A.” me nr. të prokurimit KRUP 19 018 2-2-1, 70433736-19-1166-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina Sh.A.



dokument është dhënë leja për Substancën aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo - Dez pelet, Sasia / forma: 8 ton, Nr. i notifikimit: 0268/4193/14/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticid ku në të thuhet se “Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj” dhe se “Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes”.

- Po ashtu, në lidhje me këtë, Eksperti sqaron se me datë 07.05.2019 AK ka kërkuar sqarime nga OE i është përgjigjur AK duke dërguar dokumentin prej tre faqesh të nënshkruar dhe vulosur me titull “Leje për import të produkteve biocide të notifikuara” të datës 15.04.2019 me numër të referencës “19/2015/1-293-DMMU” të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sqaron se ky dokument ka vulën e protokollit me datë 19.04.2019 me Nr. Prot. “2016-2/19”. Eksperti sqaron se në këtë dokument është dhënë leja për Substancën aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo - Dez pelet, Sasia / forma: 5 ton, Nr. i notifikimit 1496/2015/19/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticid dhe se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk kërkuar saktësisht emri i produktit biocid dhe në këtë dokument thuhet se “Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj” dhe se “Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes”.

### **Përgjigje në Pretendimin nr. 3**

- Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 68 dhe 72 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme, Eksperti fillimisht sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar “Operatori Ekonomik Tenderuesi me rastin e dorezimit të tenderit duhet të deshmojnë se ka kryer së paku dy shërbime të ngjajshme në tri vitet e fundit, duke filluar numerimi prapa nga data e njoftimit për kontratë” dhe si dëshmi “a.(i) nese shërbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben një Letër Reference të lëshuar nga ana e AK OSE fletdergese fletpranim ose dokumentit për pranim teknik të pajisjeve, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga ana e AK. ; a.(ii) nese shërbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti që evidenton një ekzekutim të tillë”.

- Po ashtu, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar Listën e kontratave për tre vitet e fundit me gjithsej katër kontrata të përfunduara në vitet 2017, 2018 e 2019 dhe ka ofruar këto dëshmi: 1. “Kontratë shërbimi” e lidhur me datë 04.01.2018 e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët në mes të “VIVA FRESH SHPK” e “VLERA NSHP” ku lënda e kontratës është “DDD” me afat kohor “01.01.2018 deri 31.12.2018”; 2. “Raport pune” lëshuar nga Komuna e Obiliqit për projektin “Deratizimi i ambulancave, qerdhja e qytetit dhe shf. I. Rugova” me nr. të prokurimit “614 18 070 236” ku thuhet që “shërbimet janë kryer me datë 15.12.2018” dhe e cila është nënshkruar nga OE dhe projekt menaxheri; 3. “Faturë nr. 4P/18” e datës 17/12/2018 e nënshkruar për projektin e përmendur në pikën nr. 2; 4. “Letër referencë për DDD” lëshuar nga “VIVA FRESH SHPK” e datës 01.03.2016 ku thuhet që “kontrata është lidhur për afat prej janar 2016, janar 2017 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar”; 5. “Letër referencë për DDD” lëshuar nga “VIVA FRESH SHPK” e datës 01.03.2017 ku thuhet që “kontrata është lidhur për afat prej janar 2017, janar 2018 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar”.

### **Përgjigje në Pretendimin nr. 4**

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 68 dhe 72 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar pajisjet e kërkuara, Eksperti fillimisht sqaron se në dosje të tenderit Aneksi 7 është dhënë një listë nga ana e AK e cila duhet të plotësohet nga OE ofrues dhe sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar dy Lista të pajisjeve: “Listën e pajisjeve siç është kërkuar sipas Aneksit 7” të nënshkruar dhe vulosur nga anëtari i dytë i grupit me gjithsej 7 pajisje e për të cilat ka ofruar sasi të ndryshme dhe “Listën e pajisjeve të kërkuar sipas dosjes së tenderit” me gjithsej pesë pajisje e për të cilat është dhënë përshkrimi se ku mund të gjenden në dokumentacion ku për secilin artikull ka ofruar faturat



përkatëse për anëtarin e grupit EKO DEZ DOO në gjuhën serbe, në to ka të shkruar më laps kimik shkrim në to mirëpo mund të shihet saktë përshkrimi i produktit të blerë. Po ashtu, OE ka ofruar edhe dokumente tjera si polisa të sigurimit, certifikata regjistrimesh për automjete, deklarata për kapacitet teknik të nënshkruar dhe vulosur ku shihet se posedon spërkatës dhe magazinë për ruajtje të prepareve për kontroll të mushkonjave në gjuhën serbe të paguara, andaj kjo pikë është e paqëndrueshme.

### **Mendimi i Ekspertit shqyrtues**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e sipërpërmendur nr. 1 deri nr. 4) dhe të mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie të kontratës.